



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 173/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Prizeren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizeren, për shkak të vendosjes të banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), ndërsa Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prizeren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizeren, në të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 14:20, aktivistja Marigone Drevinja ka vërejtur se mbi rrugën “Ismet Jashari-Kumanova” në Prizeren ishte vendosur baneri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Irfan Fusha nga radhët e PDK-së. Me të cilin veprim sipas parashtresës të ankesës është bërë shkelje e nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 dhe Nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtresësi i ankesës ka bashkangjitur si provë dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është kundër këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesën për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 17:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën deklaroi se posterat e kandidatit në fjalë janë hequr nga vendi ku kanë qenë të vendosura dhe se brenda afatit të paraparë është përmirësuar shkelja dhe si dëshmi ka bashkangjitur tri fotografi nga vendi i ngjarjes duke i larguar banerët nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PDK, ka vendosur banerin mbi rrugën publike "Ismet Jashari-Kumanova" në Prizeren, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parashihet se "Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore" si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK) që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara siq ka theksuar në përgjigjen në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.173 /2014 më datën 08.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmanj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.